



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 261, datë 10.12.2024

PËR

**“PËRFUNDIMIN E PROCEDIMIT DISIPLINOR TË FILLUAR NDAJ ISH-MAGJISTRATIT LORENC MËRKURI, PA NJË VENDIM PËRFUNDIMTAR”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar
3. Zotit Zeqir HODA	Anëtar (në mungesë)
4. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar
5. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar
6. Zotit Moisi DUDA	Anëtar
7. Zotit Vatë STAKA	Anëtar
8. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar (në mungesë)
9. Zotit Erind GËRMENJI	Anëtar
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar
11. Zoti Erion Fejzulla	Anëtar

në mbledhjen e datës 10.12.2024, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 e vijues, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar dhe nenet 18 e vijues të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

***“Përfundimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit Lorenc Mërkuri, pa një vendim përfundimtar”***

**BAZA LIGJORE:**

1. Nenet 149, pika 1, 149/a, pika 1, shkronjat “b” dhe “e”, si dhe 179/b, pika 7 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë;



2. Neni 164, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
3. Nenet 164, pika 8, 166, pikat 2 dhe 6, 189, pika 1, germa “a” dhe 192, pika 1, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar;
4. Neni 95, i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

### KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- i. Relacioni shoqërues nr.2649 prot., datë 03.12.2024, i Komisionit Disiplinor;
- ii. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;

si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

### V Ë R E N:

1. Pranë Këshillit është depozituar shkresa nr. 459/26 prot., datë 23.11.2022, “Kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit Lorenc Mërkuri, aktualisht me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë”, e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me të cilën është propozuar caktimi ndaj magjistratit Lorenc Mërkuri, e masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 % për një periudhë jo më të gjatë se një vit”, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar<sup>1</sup>.
2. Rezulton se, paralelisht me procesin e mësipërm disiplinor të ILD-së ndaj magjistratit Lorenc Mërkuri, në cilësinë e subjektit të rivlerësimit, është zhvilluar edhe një proces tjetër administrativ sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
3. Në përfundim të këtij procesi, me vendimin nr. 450, datë 22.09.2021, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur shkarkimin nga detyra të prokurorit Lorenc Mërkuri<sup>2</sup>. Ndaj këtij vendimi, prokurori Lorenc Mërkuri ka paraqitur ankim<sup>3</sup> në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, ku është regjistruar çështja (JR) nr. 76/2021, datë 02.12.2021.
4. Në përputhje me Pikën 6, të Nenit F, të Aneksit “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kur ushtron ankim kundër masës disiplinore të shkarkimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, subjekti i rivlerësimit pezullohet nga detyra deri në marrjen e vendimit nga Kolegji i Posaçëm të Apelit.

<sup>1</sup> Më tej “Ligji për Statusin”

<sup>2</sup> <https://kpk.al/wp-content/uploads/2021/11/Vendim-Lorenc-Merkuri.pdf>

<sup>3</sup> <https://kpa.al/njoftim-665/>



5. Referuar përcaktimeve ligjore shprehur në nenet 126 dhe 145, të Ligjit për Statusin, si dhe nenit 66 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Këshilli ka konsideruar se është në kushtet e pezullimit të procedimit disiplinor të filluar nga ILD-ja deri në përfundim të procesit së rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë, duke vlerësuar se mbajtja ose jo e statusit të magjistratit nga prokurori Lorenc Mërkuri, përbën parakusht për shqyrtimin në themel të procedimit disiplinor të ILD-së, të filluar në ngarkim të tij.
6. Në zbatim të dispozitës kushtetuese cituar në pikën 7, Këshilli ka marrë vendimin nr. 19 datë 16.01.2023, “Për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit Lorenc Mërkuri, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë”, duke pezulluar procedimin disiplinor në ngarkim të magjistratit Lorenc Mërkuri, deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.
7. Pas shqyrtimit të ankimit të prokurorit ndaj vendimit nr. 450, datë 22.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me vendimin e shpallur në dt. 24.10.2024, Kolegji i Posaçëm i Apelit<sup>4</sup> ka vendosur lënien në fuqi të vendimit për shkarkimin nga detyra. Me marrjen formë të prerë të këtij vendimi, zoti Lorenc Mërkuri ka humbur statusin e magjistratit, duke mos e ushtruar më këtë funksion.
8. Me rënien e shkakut ligjor të pezullimit, me vendimin nr. 245, datë 13.11.2024, “Për shfuqizimin e Vendimit nr. 19, datë 16.01.2023, “Për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit Lorenc Mërkuri, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë”, Këshilli ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pezullimit dhe vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor.
9. Procesi i rivlerësimit kalimtar dhe procedimi disiplinor sipas Ligjit për Statusin janë dy procese të pavarura nga njëri tjetri që zhvillohen nga organe të ndryshme, të pavarura dhe sipas procedurave të ndryshme ligjore. Këto procese kanë ndikim ndaj njëri tjetrit duke përcaktuar vijueshmërinë e tyre. Kështu, procesi i rivlerësimit, që është një proces i detyrueshëm për të gjithë prokurorët në detyrë (në momentin e miratimit të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016), përcakton vijimin e gëzimit nga ata të statusit të magjistratit sipas Ligjit për Statusin. Nga ana tjetër, moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit passjell mbarimin e menjëhershëm të statusit të magjistratit.
10. Në nenin 164, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit për Statusin, në dispozitat kalimtare, parashikohet se: “1. Gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj vetëm nëse: .... b) kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>4</sup> <https://kpa.al/njoftim-vendimi-268/>



11. Neni 179/b, pika 7, e Kushtetutës parashikon se: *“7. Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë...”*.
12. Sa më sipër, prokurori Lorenc Mërkuri nuk gëzon më statusin e magjistratit dhe nuk mund të jetë më objekt i veprimtarisë së Këshillit. Mënyra e përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar (pas vendimit datë 24.10.2024, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit) ndaj zotit Lorenc Mërkuri ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe kushtëzon vijimin e procedimit disiplinor ndaj tij, në harmoni dhe me përcaktimin e nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, kod i cili është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga Këshilli (neni 189, pika 3, i ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”* i ndryshuar).
13. Në vijim, referuar nenit 95, të Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet se: *“Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”*, shqyrtimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit Lorenc Mërkuri, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë duhet ndërprerë pa një vendim përfundimtar për shkak se objekti për të cilin kishte nisur është bërë i pamundur.

**Përsa më sipër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, konstaton se:**

14. Prokurori Lorenc Mërkuri nuk gëzon më statusin e magjistratit dhe nuk mund të jetë më objekt i veprimtarisë së Këshillit.
15. Referuar Relacionit shoqërues nr. 2649 prot., datë 03.12.2024, Komisioni Disiplinor, unanimisht i ka propozuar Këshillit, përfundimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit Lorenc Mërkuri, pa një vendim përfundimtar.

**PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenet 149, pika 1, 149/a, pika 1, shkronjat “b”, “e” dhe 179/b, pika 7, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenin 164, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, nenet 164, pika 8, 166, pikat 2 dhe 6, 189, pika 1, germa “a”, dhe 192, pika 1, të ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”* i ndryshuar dhe në nenin 95 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”* i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Përfundimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit Lorenc Mërkuri, pa një vendim përfundimtar.
2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet zotit Lorenc Mërkuri dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.



3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

U shpall në Tiranë, sot më 10.12.2024.



**KRYETAR**  
Mirela Bogdani

**ANËTAR**  
Arta Mandro

**ANËTAR**  
Vatë Staka

**ANËTAR**  
Erion Fejzulla

**ANËTAR**  
Ledina Riza

**ANËTAR**  
Erind Gërmenji

**ANËTAR**  
Sokol Stojani

**ANËTAR**  
Moisi Duda

**ANËTAR**  
Erind Merkuri